

V E N D I M
Nr. 611, datë 4.12.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 303, DATË 1.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË AKREDITIMIT NË ARSIMIN E LARTË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 13 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 303, datë 1.7.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

1. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vjon:

"2. Këshilli i Akreditimit është organ kolegjal. Anëtarët e këtij këshilli emërohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, i cili miraton edhe statutin e këtij këshilli.

Këshilli përbëhet nga 9 veta, personalitete (akademikë, me tituj shkencorë e me përvojë), në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe të ekonomisë shqiptare.

Kryetari i Këshillit të Akreditimit emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Ai shpërblehet çdo muaj me 20 për qind të rrogës së profesorit, kurse anëtarët me 15 për qind të rrogës së profesorit."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, zëri "Mallra dhe shërbime të tjera".

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano